

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration
Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 18 TETOR 2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 18 OKTOBRA 2007. GODINE

TETOR – OKTOBAR
2007

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 27 shtatorit 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit;
4. Vazhdimi i procedimit të amendamenteve lidhur me Rregulloren e Punës të Kuvendit;
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për telekomunikacion lidhur vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor;
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër;

DNEVNI RED

1. Usvajanje Zapisnika sa plenarne sednice od 27 septembra 2007. godine;
2. Vreme za poslanička pitanja;
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti životne sredine;
4. Nastavak procediranja s amandmanima na Poslovnik o radu Skupštine;
5. Razmatranje Preporuke Komisije za telekomunikacije u vezi sa primedbama UNMIK-a, na Zakon o drumskom saobraćaju;
6. Razmatranje Preporuke Komisije za javne službe u vezi sa primedbama UNMIK-a, na Zakon o izmeni i dopuni Zakona o katastru;
- 7.

AGENDA

1. Approval of the minutes of the plenary session of 27 September 2007;
2. Time for parliamentary questions;
3. First reading of the Draft Law on Protection of the Environment;
4. Ongoing proceeding of amendments in the Rule of Procedure of the Assembly;
5. Discussion of the recommendation of Committee of the Telecommunication regarding the UNMIK remarks of Law on Road Traffic Safety;
6. Discussion of the recommendation of Committee of the Public services regarding the UNMIK

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS TË MBAJTUR MË 18 TETOR 2007

Seanca filloi punën në orën 10:00.

Seancën e kryesoi Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Që në fillim, ju njoftoj se, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme.

Mirëpo, ndërkohë kemi një kërkesë të Grupi Parlamentar ORA, që të vihet në rendin e sotëm të ditës debati rreth gjendjes në SBASHK.

Duke iu referuar Rregullës 29.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit për çështje urgjente dhe duke pasur parasysh gjendjen e krijuar me rastin e grevës së urisë në SBASHK, si dhe gjendjen shëndetësore të grevistëve, duhet kërkuar mundësinë për gjetjen e zgjidhjes.

Prandaj, ju lusim që rendi i ditës të zgjerohet me pikën urgjente për çështjen që ka të bëjë me situatën e krijuar me rastin e grevës së urisë të anëtarëve të SBASHK-ut.

Kjo është kërkesë e ORA-s.

Fjalën e ka zoti Veton Surroi.

A është tërhequr nga fjala?

TEUTA SAHATQIJA: Jo, nuk është tërhequr. Vetëm pak, ju lutem. Është fjala për kartelën.

I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Ashtu siç e cekët ju, duke iu referuar Rregullës 29.2 e cila ka të bëjë me çështjen urgjente, kërkojmë që rendi i ditës të zgjerohet me pikën - Situata e krijuar me rastin e grevës së urisë të anëtarëve të SBASHK-ut, si pikë e parë.

Greva ka hyrë në ditën e nëntë dhe asaj i janë bashkëngjitur edhe punëtorë të shkollave të tjera në mënyra të ndryshme. Gjithashtu, është edhe një grevë urie, që mbahet në Shkollën “Mazllom Këpuska” në Gjakovë, ku 5 punëtorë janë përfshirë, prandaj e gjithë kjo tregon një seriozitet, një situatë të vështirë të qytetarëve tanë.

E gjithë kjo arsyeton urgjencën, sidomos duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të grevistëve dhe kërkon një angazhim të përgjithshëm.

Prandaj, ne si Kuvend dhe institucioni më i lartë, duhet të jemi në nivel dhe t'i përgjigjemi kërkesës së tyre.

Ne, si Grup Parlamentar, kërkojmë që kjo të votohet dhe të ngritet në nivel të debatit, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje sa më e shpejtë dhe sa më e drejtë për çështjen e arsimit dhe çështjen e grevës së SBASHK-ut. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kërkesa i plotëson kushtet sipas Rregullës 23.2, prandaj e hedhim në votim. Votojmë tash.

Me 36 vota “kundër” dhe 30 “për”, nuk miratohet kërkesa.

(Pasi nuk u miratua kërkesa o ORA-s, deputetët e kësaj partie e braktisën seancën plenare)

KRYETARI: Vazhdojmë punën me pikën e parë të rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 27 shtator 2007

Fjalën e kërkon Nait Hasani.

NAIT HASANI: I nderuar Kryetar, të nderuar ministra,

KRYETARI: Nait, po bisedojmë për rendin e ditës.

NAIT HASANI: Për rend të ditës e kam fjalën.

KRYETARI: Jo. Rendi i ditës është aprovuar.

NAIT HASANI: Kur është miratuar?

KRYETARI: Është pika e parë e rendit të ditës – Miratimi i procesverbalit të seancës plenare.

NAIT HASANI: Jo. Nuk u krye rendi i ditës, ju lutem!

KRYETARI: E kemi kryer, Nait.

NAIT HASANI: Ju kërkua ta votojmë kërkesën e ORA-s. Asgjë tjetër s'kërkua.

KRYETARI: Po! Por vetëm ky ndryshim ka qenë. Vetëm kjo kërkesë ka qenë.

NAIT HASANI: Por ne, mund ta ndryshojmë rendin e ditës, mund të vendosim për rendin e ditës.

KRYETARI: Jo nuk është e mundshme. Vetëm nëse paraqitet me shkrim, me kohë. Ju lutem, shikoni Rregullën 23 të Rregullores së Punës.

NAIT HASANI: Ju lutem! Unë kam të drejtë, si deputet, të ngrit çështjen për rend dite. Ju keni të drejtë ta miratoni a të mos e miratoni. Kjo është çështje juaj.

KRYETARI: Deputeti ka të drejtë të ngritë çështjen për rend dite, por duhet ta bëjë këtë me shkrim dhe në kohën e duhur.

NAIT HASANI: Në seancë, mund ta ngrisim! Unë kam të drejtë ta ngris çështjen.

KRYETARI: Dëgjoni edhe këtë! Rregulla 23.2 thotë: "Në fillim të seancës plenare, ky propozim i rendit të ditës, do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë – anëtarë të Kuvendit, i propozojnë me shkrim kryetarit të Parlamentit një rend dite, i cili hidhet në votim".

NAIT HASANI: Kur është miratuar ky rend i ditës, ju lutem?

KRYETARI: Ju lutem, rendin e ditës, e përcakton Kryesia e Kuvendit dhe nëse në ndërkohë nuk ka ndonjë kërkesë me shkrim, sikur që është kjo e ORA-s, konsiderohet se rendi i ditës është i miratuar.

NAIT HASANI: Ju lutem Kryetar! Kryesia e Kuvendit, ka të drejtë ta procedojë rendin e ditës dhe në Kuvend të miratohet rendi i ditës.

KRYETARI: Shikoni Rregulloren, ju lutem! Vazhdojmë më tutje.

NAIT HASANI: Ju lutem!

KRYETARI: A ka kush të thotë diçka, lidhur me rendin e ditës? Urdhëroni Ilmi! E ka fjalën Ilmi Ahmeti.

ILMI AHMETI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, të nderuar deputetë,

Unë shtroj një pyetje për Kryesinë e Kuvendit të Kosovës. Në seancën e gushtit kishim në rend dite miratimin e një projektrezolute për "Trepçën", të hartuar nga Komisioni për Ekonomi....

KRYETARI: Ju lutem, zoti Ahmeti, jemi te pika e parë e rendit të ditës, rreth procesverbalit. Nëse keni diçka rreth kësaj pike, urdhëroni!

ILMI AHMETI: Rreth procesverbalit s'kam, por rreth kërkesës së Komisionit për t'u shtyrë për dy javë, e u bën dy muaj që nuk u vu në rend dite miratimi i Rezolutës.

KRYETARI: Shkojmë më tutje. A ka dikush lidhur me procesverbalin? Nuk ka. Konstatohet se miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Koha për pyetje parlamentare.

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve - për Qeverinë, është kufizuar në 50 minuta.

Në afatin e paraparë, janë parashtruar 7 pyetje parlamentare.

Pyetjet, të cilat nuk arrijnë të procedohen sot, do të radhiten për seancën tjetër.

Ju njoftoj se Kryeministri, të cilit i janë bërë disa pyetje, na ka njoftuar me një shkresë se nuk mund të marrë pjesë në këtë seancë. Prandaj, pyetjet, të cilat i janë drejtuar atij, shtyhen për t'u shqyrtuar në seancën e radhës.

Deputetja Sanije Aliaj, ka pyetje për Kryeministrin Çeku. A doni ta parashtroni pyetjen? Jo, sepse nuk është Sanija këtu.

Deputeti Xhevat Bislimi! Nuk është as ai.

Deputeti Nait Hasani, ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku. A doni ta parashtroni pyetjen? Po. Urdhëroni! E ka fjalën Nait Hasani.

NAIT HASANI: Edhe pse, për të dytën herë, sillesh në mënyrë diskriminuese ndaj nesh, unë përsëri do ta lexoj pyetjen. Herën e kaluar, nuk më keni lejuar, vetëm mua, ta lexoj pyetjen parlamentare edhe pse ka qenë Kryeministri këtu. Kjo është një shkelje, që ju e keni bërë si drejtues i Kuvendit.

Përndryshe, pyetja për Kryeministrin është:

Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë sociale në Kosovë dhe varfërinë e skajshme, në këtë rast, varfërinë e pensionistëve, të cilët, në mungesë të pensioneve të tyre, për punën dhe kontributin që i kanë dhënë kësaj shoqërie, pensionistët janë kthyer në raste sociale.

Me vlerat dhe kontributet e tyre, pensionistët meritojnë trajtim njerëzor dhe unë kërkoj të trajtohen si qytetarë të denjë të Kosovës.

Pyetja: Pse nuk erdhi Ligji për pensionistët në Kuvendin e Kosovës dhe kush e ndaloi mosardhjen e tij, për shqyrtim?

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Gjylshen Berisha ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku. Zonja Berisha, mund ta parashtrojë pyetjen.

GJULSHEN BERISHA: Meqë mungon Kryeministri, unë do të prisja, përsëri, përgjigje nga Kryeministri.

Pyetja është: Në emër të Grupit të Grave Deputete, shprehim interesimin për çështje gjinore. Çfarë masash ka ndërmarrë Qeveria për zbatimin e Ligjit për barazi gjinore dhe sa funksionon Zyra për Barazi Gjinore?

Presim përgjigjen në seancën e ardhshme.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputetja Safete Hadërgjonaj, ka pyetje për Kryeministrin. A dëshironi ta parashtroini pyetjen? E ka fjalën Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!
Unë kam një pyetje për Kryeministrin. Kryeministri, në seancën e datës 13. 3. 2007, ka deklaruar se në prill do të finalizohet dhe do të miratohet në Qeveri - Strategjia dhe plani zhvillimor i Kosovës 2007 – 2013 dhe më së largu, në qershor, do të miratohet në Kuvend.

Meqenëse ne jemi në fund të tetorit dhe ende nuk është shqyrtuar Strategjia zhvillimore, pyetja ime ishte: Çfarë po ndodhë me Strategjinë dhe me planin zhvillimor të Kosovës 2007 – 2013?

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti Nazim Jashari, ka pyetje për Kryeministrin. Nuk qenka këtu.
Deputeti Xhevat Bislim, edhe ai nuk është këtu.
Deputeti Hydajet Hyseni, ka pyetje për Qeverinë e Kosovës dhe ministrin për Kthim dhe për Komunitete.
A dëshironi ta parashtroini pyetjen, zoti Hyseni?

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Pyetja ime për Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë përkatëse, në këtë rast Ministrinë për Kthim, do të thotë pyetja e parë ka të bëjë me: Pozitën e të zhvendosurve me dhunë nga komunat e Bujanocit, të Medvegjës e të Preshevës.

Pyetja kërkon përgjigje: Çka ka bërë Qeveria, ndërkohë, për adresimin, zgjidhjen ose së paku zbutjen e problemeve me të cilat përballen rreth 12.000 qytetarë të zhvendosur në Kosovë.

Meqë ministri nuk është këtu, unë dua të theksoj se një përgjigje të tillë ua kemi borxh, jo vetëm qytetarëve të zhvendosur në Kosovë, pa të drejtë, por edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Kurse, pyetja e dytë, kjo për Qeverinë, Kryeministrin.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Le t'i jepet mundësia të shtojë pyetjen.

HYDAJET HYSENI: Lus që të konsiderohet, do të thotë, si pyetje tjetër, pyetje e dytë, për Kryeministrin dhe Ekipin e Unitetit.

- Cila është e vërteta për të ashtuquajturin "Traktat i miqësisë me Serbinë" dhe të ashtuquajturën "Deklaratë e Nju-Jorkut"?

Ndërkohë, do të duhej bashkëngjitur edhe përgjigja – e vërteta "për të famshmet 14 pikat e Treshes".

Unë këtë pyetje e shtroj edhe në emër të Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe jam i bindur se është kërkesë e gjerë e numrit më të madh të qytetarëve të Kosovës. Presim përgjigje, zoti Kryetar.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje të tjera, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 3 tetor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Ardian Gjini, që ta marrë fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Projektligji për mbrojtjen e mjedisit, ka qenë i aprovuar nga Kuvendi në vitin 2003, në atë kohë kur ne nuk e kemi pasur obligim, në bazë të marrëveshjeve tona dhe në bazë të vendimeve që janë marrë më vonë nga Kuvendi, që t'i implementojmë të gjitha direktivat evropiane, të cilat dalin ose të cilat na obligojnë neve që t'i implementojmë me këtë ligj.

Për këtë arsye, ne kemi sjellë edhe një herë Ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe kemi quajtur si ligj të ri për mbrojtjen e mjedisit, meqenëse ka pasur ndryshime të mjaftueshme dhe nuk kemi mund ta quajmë, thjesht, Ligj për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

Problemet e mjedisit, kanë qenë gjithmonë pjesë përbërëse e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili mundëson depërtime të reja në planifikim, duke siguruar një shqyrtim gjithpërfshirës të gjithë faktorëve që e karakterizojnë zhvillimin e një civilizimi modern.

Në vitin 2003 është miratuar Ligji për mbrojtjen e mjedisit, si Rregullore 2003/9, që ka rezultuar deri diku me një sukses në lidhje me promovimin e menaxhimit me mjedis në Kosovë.

Gjatë kohës së implementimit të tij dhe vlerësimit me AKI të BE-së, janë vërejtur mangësi në Ligjin aktual, kështu që është marrë vendimi për ndryshimin e tij dhe për të sjellë kërkesat mjedisore në përputhshmëri me standardet evropiane.

Ligji për mbrojtjen e mjedisit, rregullon:

- sistemin integral të mbrojtjes së mjedisit, i cili përmban masat, kushtet dhe masat për menaxhim të qëndrueshëm me vlerat natyrore;
- parandalimin e ndotjes;
- kontrollin e zvogëlimit të ndotjes;
- masat e sanimit të gjitha formave të ndotjes së mjedisit; dhe
- ekzekutimin e masave ose edhe inspektimin.

Nevoja e nxjerrjes së këtij ligji, ka të bëjë me balancimin e dëshiruar në mes aktivitetit njerëzor dhe zhvillimit të mbrojtjes së mjedisit. Kërkohet ndarje e përgjegjësisive dhe përbushje e obligimeve, të cilat janë edhe e drejtë dhe në mënyrë të qartë të definuar nga referenca konsumuese dhe sjellja e drejtë me mjedisin dhe resurset natyrore. Kjo përfshin integrimin e rrethanave mjedisore në formulimin dhe implementimin e politikave ekonomike, sektoriale në vendimet e autoriteteve publike në drejtimin dhe zhvillimin e procesit të prodhimit dhe sjelljes së individëve.

Kjo na tregon edhe nevojën për këtë ligj, i cili do të kontribuojë në ruajtjen, mbrojtjen, përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe përdorimin e kujdesshëm dhe racional të burimeve natyrore të Kosovës.

Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë kornizën ligjore për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me kushtet dhe direktivat e BE-së, si dhe definimin e standardeve përkatëse të mbrojtjes së mjedisit që sigurojnë një mjedis të shëndoshë në Kosovë.

Ndryshimi i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit është marrë si prioritet, bazuar në strategjinë legislative të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të Qeverisë, me të cilën bazë do të krijohet mundësia për shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e misioneve në mjedis, pra, ndalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmasimin e mjedisit të dëmtuar.

Gkithashtu- përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, ruajtjen dhe mirëmbajtjen

- ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtëritshme dhe të papërsëritshme,
- menaxhimin e qëndrueshëm të tyre;
- bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
- bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit si

- nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit.

Ligji ka strukturën dhe përmbajtjen e vet dhe është i përberë nga 12 kapituj(krerë)

Kreu I, përfshin qëllimet dhe lëndën e rregullimit; përkufizimet, si gjithmonë; organet përgjegjëse, pra administrimin e mbrojtjes së mjedisit; parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit dhe instrumentet për mbrojtjen e mjedisit.

Kreu II, ka të bëjë me shfrytëzimin dhe me mbrojtjen e resurseve natyrore;

Kreu III, ka të bëjë me dokumentet për mbrojtjen e mjedisit;

Kreu IV, ka të bëjë me masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit;

Kreu V, ka të bëjë me monitorimin dhe informimin në mjedis;

Kreu VI, ka të bëjë me informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në mjedis;

Kreu VII, ka të bëjë me organizatat për informimin e mjedisit. Këtu kemi të bëjmë me përcaktimin e detyrave të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, e cila është themeluar rishtazi;

Kreu VIII, ka të bëjë me përgjegjësinë për ndotjen e mjedisit;

Kreu IX, për financimin e mbrojtjes së mjedisit;

Kreu X, për mbikëqyrjen;

Kreu XI, për dispozitat ndëshkuese dhe

Kreu XII, për dispozitat përfundimtare.

Me këtë, unë ftoj Kuvendin e Kosovës që ta votojë këtë ligj, si një ligj tejet të rëndësishëm për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit

Nga Grupi Parlamentar i LDK, fjalën e ka zoti Shaban Halimi.

SHABAN HALIMI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, të nderuara kolege e kolegë deputetë,

Anëtarët e komisionit funksional, kanë lexuar ligjin dhe kanë bërë një krahasim të këtij projektligji me ligjin e mëparshëm, të aprovuar në vitin 2003.

Projektligji në fjalë, plotëson standardet dhe këtë ligj e bën më të aplikueshëm në terren. Ligji i mëparshëm, ka qenë një ligj, i cili nuk ka plotësuar lëmin e lejeve në fushën mjedisore. Gjithashtu, nuk ka përcaktuar mirë përgjegjësitë e ndotësve kryesorë të

ambientit, sipas parimit – ndotësi paguan. Po ashtu, nuk ka qenë e rregulluar as çështja e inspektoratit dhe e gjobave në përgjithësi.

Me këtë ligj, bëhet standardizimi sipas 6 direktivave të Bashkësisë Evropiane, të cilat ligji i mëparshëm nuk i ka pasur.

Prandaj, anëtarët e Komisionit funksional të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kanë vendosur që në parim këtij ligji t'ia japin votën e vet – për.

Sigurisht se anëtarët e Komisionit kanë edhe vërejtjet dhe sugjerimet e veta. Gjatë amendamentimit ne do të japim kontributin tonë që ky ligj të jetë më cilësor.
Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të PDK, deputeti Canziba.

XHELAL CANZIBA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pasi është analizuar shkurtimisht masa deri në cilën parimet e Konventës së AHUS-it, janë përfshirë në legjislacionin mjedisor të Kosovës, ka disa aspekte të përfshirjes së AHUS-it në legjislacionin ekzistues mjedisor që ende mbeten të paqarta.

Në përgjithësi mund të thuhet se, me përjashtim të disa rasteve, kërkesat e AHUS-it për qasje në informata, pjesëmarrje publike dhe qasje në drejtësi mjedisore në përgjithësi, janë inkorporuar në ligjet vendore aktuale, duke filluar nga ligjet të cilat mbajnë referenca të drejtpërdrejta në Konventën e AHUS-it, si për shembull Ligji për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji për mbeturinat.

Pjesët e tjera të legjislacionit, në një mënyrë apo në një tjetër, përmbajnë parimet e AHUS-it, duke siguruar kështu elemente të mjaftueshme ligjore për të mundësuar qasjen në informata, pjesëmarrjen publike si dhe qasjen në drejtësi. Përafrimi i ligjeve nacionale të Kosovës me parimet e Konventës së AHUS-it dëshmon se këto rregulla nuk shihen vetëm si formulime abstrakte që nuk kanë rëndësi praktike për individët as institucionet publike që kanë të bëjnë me mbrojtësin e mjedisit.

Parimet e AHUS-it, në legjislacionin mjedisor, janë pranuar në kohë të qëlluar nga autoritetet e Kosovës në procesin e krijimit të ligjeve mjedisore dhe kanë shërbyer si një pikënisje për zhvillim të zgjidhjeve ligjore dhe përfshirjen e aspekteve për qasje në informata.

Pjesëmarrja publike dhe qasja në drejtësi, në fushën e mjedisit, duke ditur karakterin jo të detyrueshëm ligjor të AHUS-it nga Konventa nuk është ratifikuar ende edhe pse kapitulli III i Kornizës Kushtetuese mundëson një vrotim të tillë. Ligjvënësit në Kosovë, me kohë kanë kuptuar rëndësinë e pranimin të kërkesave të AHUS-it në legjislacionin mjedisor në të gjitha përpyekjet e tyre për të zhvilluar legjislacion të mirëfilltë dhe të përshtatshëm në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane. Kjo flet qartë për rritjen e kuptimit të parimeve kyçe të legjislacionit mjedisor dhe për nevojën urgjente për të përafruar legjislacionin vendor me atë të Bashkësisë Evropiane.

Megjithatë, në observimin më të afërt të përfshirjes së Konventës së AHU-sit në legjislacionin kosovar, ndikojnë një numër pengesash dhe mangësish në legjislacion, të cilat nuk duhet të kalojnë pa u vërejtur në një studim që ka të bëjë me përafrimin e legjislacionit mjedisor të Kosovës me parimet e Konventës së AHUS-it në legjislacionin vendor.

Me siguri, ka edhe shumë shembuj që tregojnë për kërkesën e Konventës së AHUS-it, siç janë shembujt e mangësive legjislative dhe vlen të përsëriten edhe një herë nga hyrja në shumë detaje.

Siç u tha më lart, parimi i pjesëmarrjes publike, duhet të gjejë shprehje në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit në pajtim me nenin 6 të Konventës së AHUS-it Ligji duhet të theksojë qartë të drejtën e publikut për të informuar rreth procedurave të vendimmarrjes mjedisore në kohë sa më të hershme, në mënyrë efikase dhe adekuate. Informacioni duhet të përfshijë aktivitetin e propozuar natyror, vendime apo draft vendime të mundshme, autoritetin publik përgjegjës për vendimmarrje dhe procedurën e planifikuar. Këto janë kërkesat që dalin nga Konventa e AHUS-it dhe duhet të përfshihen në ligj për mbrojtjen e mjedisit.

Mungesa e angazhimeve të përshtatshme sa i përket pjesëmarrjes publike në Ligjin për mbrojtjen e ajrit, është e evidente. Ashtu, siç qëndron ligji i tashëm, ai nuk ofron instrumente ligjore të mjaftueshme për të lejuar qasje në të dhëna rreth ndotjes.

Po ashtu, ky ligj dështon në sigurimin e vendit të përshtatshëm në strukturën e përgjithshme për pjesëmarrjen publike. Një dispozitë e konsultimeve të obligueshme publike, gjatë procesit të lejeve mjedisore për aktivitet të cilat shkaktojnë ndotje, do të mjaftonte në kumtesë së kërkesës së AHUS-it.

Edhe përkundër referimit të drejtpërdrejtë në Konventën e AHUS-it, autoritetet ligjvënëse kanë dështuar në sigurimin e vendit të merituar për pjesëmarrje publike në kornizën e përgjithshme të ligjit. Kjo kryesisht rezulton nga qasja e kufizuar të përdorur në ligj dhe sa i përket pjesëmarrjes në hartimin e dokumenteve dhe programeve lidhur me menaxhimin e mbeturinave, sikur që është rekomanduar edhe më herët. Ligji duhet të ofrojë një qasje më gjithëpërfshirëse, e cila do të mundësonte pjesëmarrjen publike më të gjerë në dizajnimin dhe aprovimin e programeve dhe dokumenteve të lidhura me menaxhimin e mbeturinave. Ky obligim buron nga kërkesat e Konventës së AHUS-it, neni 6 dhe si i tillë meriton të përsëritet në ligjin e Kuvendit para se të hyjë në fuqi.

Sa i përket Ligjit për mbrojtjen e natyrës, kërkesat e Konventës së AHUS-it, duhet të përfshihen në mënyrë më të fuqishme. Edhe përkundër qëllimit të deklaruar të ligjit, sa i përket qasjes në informata – një përfshirje më e qartë e parimeve për qasje në informata për pjesëmarrje publike dhe për qasje në drejtësi – do të ishte parimi i AHUS-it edhe më afër aplikimit dhe aprovimit nga autoritetet lokale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të AAK, e merr fjalën Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA: Zoti Kryetar, ministra,
Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe me këtë rast ka konstatuar se Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është duke bërë një përpjekje serioze në konsolidimin e legjislacionit për mjedis, duke llogaritur se, përveç këtij projektligji, kemi kaluar edhe disa ligje të tjera për mbrojtje të mjedisit të specifikuar.

Në vitin 2003 është miratuar një ligj i tillë, mirëpo ligji në fuqi, gjatë zbatimit, ka treguar se duhet t'i bëhet një përmirësim i domosdoshëm. Ministria ka vlerësuar se ligji në fuqi ka mangësi, sidomos në fushën e mbrojtjes së mjedisit, të lejeve mjedisore, zbatimin e parimeve të konventave ndërkombëtare – ndotësi paguan, inspektimin dhe gjobat.

Grupi ynë konstaton se këto arsye janë të qëndrueshme dhe duhet hapur udhë këtij projektligji, duke shfuqizuar ligjin në fuqi. Po ashtu, kemi vlerësuar nga përmbajtja e këtij projektligji, se hartuesi ka bërë përpjekje të krijojë kushte rregullative për të nxjerrë edhe dokumente të tjera të domosdoshme mjedisore, për të cilat ka nevojë Kosova.

Përmbajtja e këtij projektligji, premtan jo vetëm shfrytëzimin, por edhe mbrojtjen e resurseve natyrore, vlerat mjedisore, zbatimin e dokumenteve dhe konventave ndërkombëtare për mjedis.

Prandaj, Grupi i AAK-së e përkrah në parim këtë projektligj dhe jemi të gatshëm që të ndihmojmë gjatë procedimit në Kuvend. Kaq. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Në emër të LDD, deputeti Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI: I nderuari Kryetar,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë të pranishëm,
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë bëri shqyrtimin e Propozimligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe, që në fillim, konstatoi se ai e avancon çështjen e mbrojtjes së mjedisit. Mbështetur në këtë dhe në faktin se mbrojtja e mjedisit është në interes të përgjithshëm të qytetarëve dhe shtetasve të Kosovës, ne e përkrahim në parim, duke propozuar që të aprovohet si i tillë.

Megjithëkëtë, ne kemi edhe disa vërejtje parimore, të cilat mendojmë se do t'i parashtrijmë dhe kontributin tonë do ta japim në fazën e mëtutjeshme nëpërmes amendamenteve.

Në pika të shkurtra, këto do të ishin:
Propozimligji, nuk përkufizon mbrojtjen e ambienteve - të cilat janë pasojë e industrisë, e që tanimë nuk funksionon, duke pasur parasysh mbeturinat e hapësirave të mëdha, siç

janë në kompleksin "Trepça" ku nga andej ngritën tymi dhe pluhuri i madh dhe masat për të ruajtur këtë ambient të shëndoshë.

E dyta. Është çështja se në këtë propozimligj dominon një kategori e përkufizimeve të tepruara, që do të ishte mirë ose të integrohen në përkufizime të përbashkëta edhe pse ndoshta është vështirë.

Dhe, çështja tjetër është, se ky propozimligj, përveç faktit se avancohet, e anulon një propozimligj i cili kishte të meta të shumta.

Bazuar në këto, ne edhe një herë kontributin tonë do ta japim në procedurën e mëtutjeshme kuvendare dhe të komisioneve adekuate. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit për Integrim, doktor Agani.

FERID AGANI: I nderuari zoti Kryetar,
I nderuari zoti ministër,
Të nderuar ministra e kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe në parim e ka mbështetur si një akt shumë të rëndësishëm ligjor. Megjithatë, më lejoni që në fjalën time të ndalem në disa nene, të cilat në njëfarë mënyre janë kundërthënës dhe nuk i shërbejnë kualitetit të këtij dokumenti ligjor.

Fillimisht, në përkufizime, kur përkufizohet mjedisi nënkuptohet edhe trashëgimia kulturore dhe në asnjë vend tjetër në Projektligj trashëgimia kulturore nuk definohet si mjedis. Prandaj, mendoj se kjo duhet të rregullohet posaçërisht duke pasur parasysh nenin 22, i cili e përcakton planin e veprimit, planin e Kosovës për veprim në mjedis, i cili në asnjë paragraf nuk e paraqet trashëgiminë kulturore si subjekt të këtij Projektligji dhe të këtij plani.

Në nenin 54 është e rregulluar çështja e qasjes në dokumente publike dhe unë mendoj se këtu duhet marrë parasysh rekomandimin e Zyrës ose të Agjencionit për Integritet Evropian, që përpos sigurimit të qasjes në informata lidhur me ndikimin në mjedis dhe në mbrojtjen e mjedisit, Ministria dhe organet përkatëse duhet të ndërmarrin edhe shpërndarje sistematike të këtyre informatave, pra jo të jetë vetëm një pozitë pasive, por të jetë një pozitë aktive në relacion me opinionin publik. Kjo do të ishte në pajtim me Direktivën 2003/4 të Komisionit Evropian.

Në nenin 62 është paraparë të formohet Bordi këshillues, si quhet në titull, ose këshillëdhënës, brenda në tekst. Mendoj se Kuvendi i Kosovës, nuk është organ i cili formon borde këshilluese. Në qoftë se ngritët një bord i tillë, atëherë ai do të ketë kompetenca shumë më të mëdha, edhe vendimmarrëse në lidhje me disa çështje, e jo të shërbejë vetëm si organ këshillues i Kuvendit dhe i Qeverisë. Pra, duhet rregulluar

çështja e mandatit të këtij bordi në qoftë se shihet si i arsyeshëm. Unë mendoj personalisht se ka vend për një organ të tillë.

Në nenin 74.2 mendoj se qëndron problematika dhe problemi më i madh lidhur me këtë Projektligj. Neni 74.2 rregullon çështjen e Fondit për mbrojtjen e mjedisit, si një institucion financiar i cili do të shërbejë si burim i të hyrave dhe si burim prej të cilit do të financohen aktivitetet lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ndërsa neni 79 rregullon mënyrën e shfrytëzimit të këtyre mjeteve.

Ne të gjithë e dimë se çfarë problemesh kemi pasur me fondet e ngjashme publike, konkretisht me Fondin për sigurime shëndetësore, me Fondin për sigurime pensionale dhe e dimë se themelimi i një fondi të tillë është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Propozimi i serishëm i themelimit të këtij fondi, megjithëse e konsideroj plotësisht të arsyeshëm dhe e mbështesë plotësisht Ministrinë në këto synime, mendoj se prapë do të na shpie në një rrugë pa krye, ku do të kemi ligj i cili nuk do të ketë burime të financimit. Ajo që duhet të bëhet paraprakisht është, domosdo, amendamenti i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe vetëm atëherë të parashihet themelimi i fondeve të tilla. Kjo qëndron edhe me vërejtjen të cilën Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave e ka bërë në tekstin e këtij Projektligji.

Dhe, përfundimisht, një vërejtje lidhur me nenet 97 dhe 98. Mendoj se periudha prej dy vitesh për nxjerrjen e akteve nënligjore, është shumë periudhë e gjatë. Serioziteti i situatës lidhur me mjedisin në Kosovë nuk lejon një komoditet të tillë, posaçërisht jo neni 98, i cili e parasheh periudhën prej dy vitesh për harmonizimin e veprimtarive të subjekteve fizike dhe juridike me dispozitat e këtij ligji. Kur e kemi parasysh nenin 101 që e qetë jashtë fuqisë ligjin ekzistues, atëherë ekziston një vakum ligjor prej dy vitesh në të cilin mund të ketë interpretime dhe keqinterpretime të dispozitave ligjore, kështu që unë mendoj se kjo duhet të precizohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar,

Zotëri ministra,

Kolegë deputetë,

Ndotja e ambientit është problem me të cilin përballen shumë shtete, por tanimë ky është problem global, e jo vetëm i shteteve veç e veç.

Në Shqipëri, nga statistikat e fundit mësojmë se 1400 njerëz vdesin në vit nga kanceri dhe si shkaktar numër një konsiderohet ndotja e ambientit.

(Kryetari: Lus deputetët që mos të largohen nga salla)

Te ne në Kosovë, për shkak të mosfunksionimit të mirëfilltë të sistemit informativ në shëndetësi, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik nuk është dalë me shifra konkrete, por

nga eksperiencia e përditshme e mjekëve që merren me shërimin e sëmundjeve respiratore, mund të thuhet se edhe te ne ky numër nuk është më i vogël.

Ky Projektligj është i vonuar dhe është dashur të reagohet më herët për ndryshimin e Ligjit të njëjtë, i cili nuk ka qenë i mjaftueshëm që ta ndalë ndotjen e ambientit dhe keqpërdorimet e tjera me pasuritë e Kosovës. por prapë se prapë fjala e vjetër “më mirë tash se kurrë”, vlen edhe tani, sepse ky është Ligj i domosdoshëm për Kosovën.

Në Pjesën hyrëse të Projektligjit, në ndikimet buxhetore, thuhet se planifikohet të bëhet Fondi për mbrojtjen e mjedisit, për sigurimin e mjeteve financiare për stimulimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit, dhe të gjitha mjetet financiare të derdhen në këtë fond.

Ligji për menaxhimin e financave publike nuk lejon formimin e fondeve, pa marrë parasysh se a do të kontrollohen me ligj. Kjo ka qenë arsyeja pse i është kthyer Ligji për sigurime shëndetësore Ministrisë së Shëndetësisë, edhe pse i ka kaluar të dy leximet në këtë Kuvend. Prandaj, i sugjeroj komisionit funksional, që gjatë amendamentimit të këtij projektligji të gjejë forma të reja të zgjidhjes së çështjes buxhetore për këtë Projektligj, që mos të ketë fatin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ministra,

Unë do të japë vetëm dy vërejtje të shkurtra të miat. Këto kanë të bëjnë me dispozitat, me procedurat e ankesës, që mendoj se këto procedura nuk e kanë vendin këtu, sepse çdo vendim të cilin e nxjerr inspektori, është vendim administrativ dhe është procedura administrative, e cila e rregullon edhe çështjen e ankimit dhe kompetencat e tjera. Kjo është në nenin 88 të Projektligjit që po e diskutojmë.

Vërejtja e dytë ka të bëjë me nenin 97, ku thuhet se Qeveria dhe Ministria në afat prej dy vitesh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet t'i nxjerrin aktet nënligjore për të cilat janë të autorizuar me këtë ligj.

Duke pasur parasysh se akoma ligjet i shpall Përfaqësuesi Special dhe nuk dihet se kur do të shpallet ky Ligj, më duket se afati prej dy vitesh për nxjerrjen e akteve nënligjore është afat shumë i gjatë dhe do të duhej të shkurtohej në gjashtë muaj, sepse ne jemi dëshmitarë të gjithë se kemi një mori ligjesh të cilat janë të pazbatueshme pikërisht për mungesën e nxjerrjes së akteve nënligjore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Me qenë se nuk ka më diskutues, shkojmë në votim, në parim.

Në sallë kemi momentalisht 68 deputetë.

Votojmë tash:

Me 64 vota "për" dhe 3 "kundër", miratohet në parim Projektligji mbi mbrojtjen e mjedisit.

Pika e katërt e rendit të ditës:

- Vazhdimi i procedimit të amendamenteve në Rregulloren e Punës së Kuvendit

Amendamentet në Rregulloren e Punës së Kuvendit janë shqyrtuar në seancën plenare të datës 27 shtator 2007, por në mungesë të kuorumit votimi i amendamenteve është shtyrë për seancën e radhës.

Ju lutem, shkojmë në votim. Urdhëroni, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Unë dua të theksoj dhe të përshëndes faktin që Kryesia ka inkorporuar ndonjë nga amendamentet e deputetëve në këtë propozim, por megjithatë, me keqardhje duhet, po ashtu, të konstatoj faktin se edhe ky propozim përsëri ka ardhur me parregullsi që vërtet vështirë mund të justifikohen. Ky dokument përsëri ka ardhur, edhe përkundër vërejtjeve që janë bërë këtu, në një formë jo standarde, jo siç i shqyrtojmë amendamentet, të radhitura njëra pas tjetrës, madje nuk janë fare në versionin përfundimtar. Me këtë nuk dua të fajësoj administratën, por mendoj se është përgjegjësi e Kryesisë, eventualisht e bartësve të kësaj iniciative. Për pasojë do ta kemi shumë të vështirë t'i shqyrtojmë amendamentet kështu siç janë.

Unë personalisht kam bashkëngjitur dy tekste me amendamente. Në variantin e fundit ato mungojnë fare. E theksoj, disa janë inkorporuar, po ato të tjerat do të detyrohem t'i shtroj nen pas neni dhe kjo do të jetë e zorshme, sepse deputetët nuk i kanë tekstet përpara.

Përveç tjerash, zoti Kryetar, unë dua, po ashtu, ta ritheksoj edhe një herë faktin se konstatimin në hyrje të tekstit të shpërndarë nga Kryesia se ky propozim është miratuar në parim, është i lëndueshëm, sepse për ta miratuar duhej shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Transkripti dhe procesverbali dëshmojnë se kjo mbështetje ka munguar edhe atëherë. Prandaj, mendoj që pa u kapur pas formaliteteve, unë jam i interesuar që ta kalojmë këtë çështje, megjithatë duhet, pikërisht në procedurën e miratimit të Rregullores, të dëshmojmë rregullsi si Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Shkojmë në aprovimin e amendamenteve një nga një.

Ka vërejtje, më falni.

Zoti Hyseni, Urdhëroni!

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit zoti Kryetar,

Është njëra nga çështjet që nuk është shumë e rëndësishme, por nuk është e përfshirë. Është propozuar me amendamentin që është shpërndarë me kohë, që në vend të

shprehjes “të paharmonizuar me anglisht” dhe tërheqë vërejtjen se ky fenomen është në gjithë tekstin. Ka pasur një harmonizim me serbishten, por jo me anglishten, kurse në Rregulloren tonë, varianti në anglisht mbetet i vlefshëm apo – mbisundon. Prandaj, edhe është propozuar që shprehja “Programi” që është jo adekuate sepse është tjetër Programi dhe është tjetër Kalendari i punës së Kuvendit, të zëvendësohet me fjalën: “Kalendari”, edhe në tekstin që ju e keni shpërndarë si Kryesi, do të thotë që e kemi në fuqi, është Kalendari i punës së Kuvendit.

Propozimi im është që shprehja: “Programi” të zëvendësohet me shprehjen: “Kalendari”.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në votim, me vërejtjen që e dha zoti Hyseni.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 63 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”... Për ta aprovuar kërkohet shumica e deputetëve të pranishëm.

KRYETARI: Lus deputetët që nuk gjenden në sallë, të kthehen të votojnë për Rregulloren.

Urdhëro, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Zoti Kryetar, në këtë amendament është bërë një përmirësim dhe unë e mbështes. E ka lehtësuar kjo miratimin. Por, megjithatë mendoj që duhet pasur parasysh se propozimi është përjashtues dhe është në kundërshtim me një mori rregullash të Rregullores sonë. Prandaj, duhet të merret parasysh propozimi i bashkëngjitur në amendamente, që thotë shprehimisht: “Në rastet kur ndonjë çështje e agjendës ka të bëjë me çështjet që lidhen me komisionin parlamentar” se i është marrë kjo e drejtë komisionit për të marrë pjesë në diskutim rreth agjendës, apo fushëveprimet të tij (dakord) me grupin e deputetëve apo deputetin individual, deputeti ose përfaqësuesi i komisionit apo grupi përkatës të deputetëve, po ashtu mund të diskutojë lidhur me agjendën dhe rendin e punës. Do të thotë, të mbetet ajo që grupi parlamentar flet nëpërmjet shefit të grupit parlamentar, por kur një çështje ngritet nga komisioni apo nga grupi i deputetëve apo edhe nga deputeti individual në përputhje me rregullat e procedurës, atij t’i mundësohet që të flas lidhur me agjendën. Propozoj vetëm që kjo të përfshihet në këtë amendament.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj se edhe Grupi Parlamentar i Aleancës konsideron se është shumë mirë e formuluar kjo dhe dëshiroj të sjellë argumentin pse është mirë e formuluar këtu në dokument.

Deri më tani arsyeja pse kemi filluar me këto reforma, ka qenë pikërisht ajo që të ngritet transparenca dhe efikasiteti i Kuvendit.

Dëshmia është se në çdo seancë, deputetët ngriten dhe kërkojnë një çështje, e cila mund të ngjajë që shpeshherë nuk është e përgatitur dhe pikërisht për shkak të punës, edhe pse agjenda paraprakisht është e përpunuar sipas rregullave, në bashkëpunim me shefat e grupeve dhe Kryesinë e Kuvendit, që thotë edhe grupi parlamentar e ka thënëien e vet, për hir të efikasitetit dhe të funksionimit më të mirë të Kuvendit, konsiderojmë se ky nen duhet të mbetet ashtu si është i shkruar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Shkojmë në votim te amendamenti numër 2, sipas tekstit që është dhënë.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 52 vota për, nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 43 vota, dhe 2 kundër, nuk miratohet amendamenti.

Urdhëroni, zoti Hamiti!

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar, kjo është temë që është shtruar tri-katër herë dhe, t'ju them të drejtën, për mua është gjë shumë e mërzitshme edhe e papërgjegjshme kjo, pse ne e sjellim kaq herë këtë problem të plotësimit të Rregullores në Parlament.

Unë po shoh edhe këtu sot, kjo është e drejtë e deputetëve që të votojnë ose të mos votojnë, por nuk është mirë që të bëjmë lojëra me këta numra të shkretë që i kemi përpara, t'i prekim ose jo. Pse po them kështu? Po them, sepse edhe këto ndryshime e kanë brendësinë e vet, njëfarë strukturimi. Ata që i kanë lexuar, e unë besoj që Hydajeti, meqë po flet shumë, i ka lexuar, e dinë që nëse njëri nen nuk miratohet, tjetri edhe nëse votohet, është problem i madh, sepse e kushtëzojnë këta njëri - tjetrin. Unë po ju them që, nëse nuk u votua neni 3, menjëherë neni 5 nuk ka pse të votohet. Prandaj, ju lutem, të merremi vesh. Kjo nuk është punë e shtyrjeve, sepse këto janë rregulla që do të vlejnjë për të gjithë. Këto nuk janë rregulla për një njeri. Nëse ky Parlament mendon që janë të dobishme këto rregulla për plotësim të Rregullores, po i votojmë. Nëse nuk mendon, unë kërkoj që kjo legjislaturë të mos i nxjerrë më në Kuvend, sepse jemi lodhur më duke i nxjerrë në variante të ndryshme.

Edhe njëherë po them, mendoj dhe i thërras kolegët që, nëse mendojnë se duhet të votohen këto rregulla, po i votojmë, por jo në këtë formë sepse do ta shihni që, nëse e

votojmë njëherë dhe nuk e votojmë tjetrën, atëherë faktikisht nuk kemi bërë asgjë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Zoti Kryetar, ne jemi në përfundim të mandatit tonë dhe është e drejtë e Kuvendit të ardhshëm, ose e përbërjes së re të Kuvendit të ardhshëm të punojë me këtë Rregullore ose me këto ndryshime, që ne i miratojmë sot, ose të bëjë një rregullore të re. Prandaj, nuk di pse ne duhet të ngutemi që tash t'i bëjmë këto ndryshime, sepse ne do të mbajmë edhe një seancë, eventualisht dy, dhe pastaj fati i këtyre ndryshimeve varet nga struktura dhe përbërja e re e Kuvendit.

Unë konsideroj se, nëse duhet t'i bëjmë hatrin dikujt që na ka ndihmuar t'i bëjmë këto ndryshime në Rregullore, që ta plotësoj projektin e vet për punën e vet në Kuvend, ne mund ta bëjmë, por sa për nevojën të Kuvendit dhe të kësaj përbërjeje, këto ndryshime konsideroj se janë krejt të panevojshme në këtë fazë dhe përbërja e re do të përcaktohet për ndryshime dhe për Rregullore të re të punës së Kuvendit.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Zoti Fatmir Rexhepi e ka fjalën. Me falni, më parë zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zotin Koci unë e dëgjova dhe u përpoqa ta kuptoj edhe atë. E kuptoj çfarë do të nënvizoj, por unë po ju them që ka edhe probleme substanciale brenda rregullave të propozuara. Problemi është edhe i emërtimeve, edhe i formimeve të komisioneve parlamentare që janë substanciale, që kanë të bëjnë me të pritshmen tonë, jo vetëm me punën të një legjislacioni. Ka brenda rregullave edhe çështje substanciale që nuk kanë të bëjnë me ndërrim të legjislaturës, por me nevojën immanente të Kuvendit. Kaq.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Zotëri Rexhepi, urdhëroni merreni fjalën!

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Unë mendoj që përgatitja, debati dhe ajo që është ofruar si projekt për ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit, e ka marrë kohën e vet dhe tani e kemi para vetes. Mendimi im është që Rregullorja është shumë e mirë, por ju kisha lutur që të mos vazhdojmë me debatin e këtillë. Nëse dëshirojmë ta kryejmë punën ashtu qysh edhe duhet ta kryejmë këtë mandat, unë mendoj që kryetarët e grupeve parlamentare duhet të merren vesh, të japin përfundimin lidhur me këtë edhe të ecim përpara, ta aprovojmë këtë rregullore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Gashi, urdhëroni!

ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është marrë me kohë me këtë çështje dhe ka vendosur që t'i mbështesë të gjithë amendamentet. Sa jam në dijeni, edhe

shifat apo grupet parlamentare të PDK-së, të AAK-së dhe tjerë janë angazhuar sinqerisht që ne t'i kryejmë këto ndryshime. Andaj, ju lus dhe i ftoj deputetët e grupeve të tjera parlamentare, sepse LDK-ja sigurisht voton "për", që ne t'i kryejmë këto ndryshime. Është çështje e legjislaturës tjetër pas zgjedhjeve se si do të vendosë, por për përfundimin e punëve të filluara, këto ndryshime janë të domosdoshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kuçi e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Unë mendoj se nuk është çështje këtu se Grupi Parlamentar i PDK-së i përkrah apo jo këto ndryshime në Rregullore. Grupi Parlamentar i PDK-së është i përgjegjshëm për punën e vet dhe i përkrah këto ndryshime. Natyrisht, ne kemi pasur konsultime paraprake. Ndërkaq, mendimet që i japin deputetët individual veç e veç, e pasurojnë ndryshimin dhe e bëjnë më funksionale Rregulloren, por kjo në asnjë rast nuk nënkupton që ne nuk i mbështesim këto ndryshime. Ajo çka dua të them është se këto ndryshime mundësojnë funksionalitetin e Kuvendit për ditët e mbetura dhe gjithsesi japin mundësi që kjo legjislaturë të përfundojë mandatin e vet ndoshta në plotësi.

Është se fakti i pamohueshëm që në legjislaturën e re dikush do të jetë, dikush jo. Ata e kanë të drejtën e vet që ditën e parë ta miratojnë këtë Rregullore, ta ndryshojnë apo të nxjerrin një rregullore të re. Me fjalë të tjera, edhe nëse bëhet ndonjë lëshim i vogël, nuk është lëshim i cili do ta dëmtojë shumë këtë legjislaturë apo edhe funksionimin e Kuvendit. Ne mund t'i mbështesim dhe mund të jenë të mirëseardhura mendimet individuale që e mbështesin funksionalitetin e Rregullores, por kjo nuk nënkupton që PDK-ja është kundër këtyre ndryshimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Nekibe Kelmendi. Mirë, deputeti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pak me vonesë, po sidoqoftë, faleminderit! Së pari ne po flasim për amendamente, kemi një praktikë. Ne kemi përbirë faktin, ta zëmë, se është anashkaluar Komisioni. Tash po e përbijmë edhe faktin se nuk janë amendamentet në tekst që ta kalojmë tekstin, do të thotë jemi të interesuar për të. Dhe, ju lutem, nëse e keni propozimin përpara, e nuk e keni për fat të keq, jo për fajin tim. Propozimi që kam bërë unë është jo përjashtues, por i shkrin dy shqetësimet e të gjithë deputetëve.

1. Që të mos lejohet që për rend dite të flasin vetëm shifat, sepse do të jenë vetëm katër, pesë vetë do të flasin dhe kjo do t'i përjashtojë komisionet. S'mund t'i përjashtoni, zotëri, komisionet. Do t'i përjashtojë kjo iniciativat e deputetëve, 5, 6 deputetë e kanë të drejtën me Rregullore, nuk mund t'i përjashtojmë edhe po të duam. Prandaj, propozimi im është bashkim i propozimit të dhënë përpara, të cilin e mbështesim me një riformulim, duke iu lënë mundësia, përveç tyre, si e zakonshme, edhe përfaqësuesve të komisioneve kur kanë çështje të komisioneve, dhe përfaqësuesve të grupit të deputetëve, kur është një nismë e grupit të deputetëve, ose edhe e deputetëve individual, sepse ka deputetë që nuk janë në grupe. Në vende të tjera dy deputet bëjnë grup, edhe ata kanë të drejta iniciojnë një çështje dhe të bëjnë një vërejtje, do të thotë si përjashtim. Propozimi, do të thotë, është përmbledhës, e përfshin propozimin e përparshëm dhe e kompletton me një

propozim. Ju duhet t'i hidhni në votë, zoti Kryetar, të dy propozimet dhe le të vendos Kuvendi, s'ka të keqe. Por mos të mbani moralizime, ju lutem!

KRYETARI: Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Megjithatë, unë flas si deputet i Kuvendit të Kosovës. Deri më sot le të më tregojë dikush që në praktikat parlamentare që një kuvend që i ka mbetur edhe një javë ose dy punë, të bëjë ndryshimin e rregullores. Ne nuk po hymë se a janë të nevojshme këto ndryshime ose jo, dhe kemi konsideruar se janë të nevojshme. Por, jo në këtë kohë dhe jo në këtë fazë. Në këtë fazë Kuvendi do të duhej të vepronte të nxirrte akte, vendime dhe ligje që janë të domosdoshme për një kontinuitet të funksionimit të institucioneve të Kosovës dhe assesi me diçka që nesër përbërja e re vërtet mund t'i miratojë këto, por edhe mund t'i hedh poshtë. Mos të bëhemi kinse po punojmë diçka si Kuvend, sepse megjithatë kjo nuk është punë, kjo është përmbushje e një formaliteti që nesër përbërja e re edhe ty, edhe mua do të na gjuajë poshtë këtë punë. Prandaj, nuk po lëshohemi në faktin se a janë të nevojshme ndryshimet ose jo. Por, koha në të cilën po i bëjmë, është krejtësisht e pakohë dhe krejtësisht e pavend.

KRYETARI: Shkojmë me amendamentin numër 4

Votojmë tash:

Me 58 vota "për" dhe 9 "kundër", nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 54 vota "për" dhe 12 "kundër", nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 56 vota "për" dhe 12 "kundër", nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 45 "për" dhe 12 "kundër", nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 8 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Me 43 vota "për" dhe 11 "kundër", nuk miratohet amendamenti.

Konstatohet se është miratuar vetëm amendamenti numër 1.

Shkojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Transport dhe Telekomunikacion lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për sigurinë të komunikacionit rrugor**

Ligji për sigurinë e komunikacionin rrugorë është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 11 janar 2007 dhe i është dërguar për shpallje PSSP-së.
PSSP-ja me shkresën e vet numër 3658 të datës 18. 8. 2007 paraqet vërejtjet konkrete në ligj. Me qëllim të përshpejtimit të shpalljes së ligjeve nga PSSP-ja është bërë praktikë që vërejtjet e UNMIK-ut në ligjet e miratuara nga Kuvendi të shqyrtohen në komisionin funksional dhe rekomandimi i komisionit funksional, së bashku me amendamentet e propozuara, të shqyrtohet në seancë plenare.

Komisioni për Transport dhe Telekomunikacion, në cilësinë e komisionit funksional i ka shqyrtuar vërejtjet e UNMIK-ut dhe rekomandimet me amendamente u janë shpërndarë deputetëve. Andaj, fillojmë të procedojmë sipas amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Në sallë janë 65 deputetë.

Me 45 vota “për” dhe 3 “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 60 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe 3 “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 51 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 50 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Me 60 vota "për" dhe 1 "kundër", miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Me 55 vota "për" dhe 2 "kundër", miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Me 56 vota "për" dhe 2 "kundër", miratohet amendamenti 11.

Konstatohet se u miratuan të gjitha amendamentet dhe ky tekst i dërgohet PSSP-së për shpallje.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për kadastër**

Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për kadastër është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 26 janar 2007 dhe i është dërguar PSSP-së për shpallje. PSSP-ja me shkresën numër 3440 datë 20.6.2007 paraqet vërejtjet e veta konkrete në këtë Ligji.

Me qëllim të përshpejtimit të shpalljes së ligjeve nga PSSP-ja është bërë praktikë që vërejtjet e UNMIK-ut në ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës të shqyrtohen në komisionin funksional dhe rekomandimet e komisionit funksional, së bashku me amendamentet e propozuara, të shqyrtohen në seancën plenare.

Komisioni për Shërbime Publike në cilësi të komisionit funksional ka shqyrtuar vërejtjet e UNMIK-ut dhe rekomandimin me amendamente u është shpërndarë deputetëve. Andaj, fillojmë të procedojmë sipas amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 60 vota "për" dhe 1 "kundër", miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 55 vota "për" dhe 2 "kundër", miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 57 vota "për" dhe asnjë "kundër", miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 60 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe 3 “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe 3 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Me 50 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe 3 “kundër”, miratohet amendamenti 14.

Konstatohet se u miratuan të gjitha amendamentet e propozuara, të cilat i dërgohen PSSP-së, për shpallje.

Mbledhja mori fund. Ju faleminderit!

Përgatiti:
Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës